



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.12.2018 ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Caktimin e datës dhe të rendit të ditës të seancës plenare për shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Petrit Vasili -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
	Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Fatmir Mediu -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane
Genc Pollo -	Kryetar i Komisionit për Integrimin Europian
Albana Vokshi -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Eduard Shalsi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Erion Braçe -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Senida Mesi –	Zëvendëskryeministre
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare

HAPET MBLEHJA

Gramoz Ruçi – Hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me rend dite: Përcaktimin e datës dhe të rendit të ditës të seancës plenare për shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nisëm e opozitës.

Siç jeni në dijeni, mbledhja e përbashkët e Këshillit për Legjislacionin dhe Komisionit të Ligjeve tashmë ka përfunduar shqyrtimin e projektligjit të paraqitur nga opozita për ndryshimet kushtetuese më datë 7.12.2018.

Në përfundim të mbledhjes janë përgatitur dhe dy raportet që do t’i kalojnë seancës plenare. Në zbatim të pikës 1 të nenit 77/b të Rregullores, raportet janë depozituar në Kuvend më datë 7 dhjetor dhe janë publikuar po në këtë datë në faqen zyrtare të Kuvendit në internet. Nga kjo datë fillon llogaritja e afatit të pikës 1 të nenit 77/b.

Këtë mbledhje e kam thirrur në përmbushje të detyrimeve që kam si Kryetar Kuvendi. Neni 77/b parashikon se “Seanca plenare për miratimin e amendamenteve kushtetuese thirret jo më parë se dy javë dhe jo më vonë se tre javë nga paraqitja e raportit”, prandaj janë dy data, njëra është këtë javë dhe i takon dita e premte 21 dhjetor, ashtu sikurse është dhe një mundësi që seancën ta zhvillojmë pas Krishlindjeve në ditën e mërkurë apo të enjte, respektivisht në datat 26 apo 27 dhjetor. Meqenëse raporti i miratuar në mbledhjen e përbashkët dhe mendimi i pakicës janë paraqitur më datën 7 dhjetor 2018 në zbatim të dispozitës që citova, propozoj që seanca plenare të thirret në datën 21 dhjetor 2018 me rend dite: Shqyrtimin i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Çfarë mendim keni për datën?

Edmond Spaho – Faleminderit zoti Kryetar. Përveç datës desha të shtroj edhe dy çështje të tjera, meqenëse ky është propozimi ynë prej katër muajsh. Data 21 dhjetor besoj se është optimale dhe aq më tepër nga sa kam dëgjuar ka një lloj para planifikimi për datën 21. Desha të thosha se tani që ka ardhur edhe opinionin e Komisionit të Venecias, për ne si opozitë bëhet edhe më e qartë që qëllimi i mazhorancës ishte që të fitonte kohë nëpërmjet dërgimit të propozimeve tona në Komisionin e Venecias. Ne kemi insistuar që nuk ishte e nevojshme që propozimi ynë të dërgohej në Venecia, pasi për këtë çështje Komisioni i Venecias është shprehur një herë në opinionin që ka dhënë për ndryshimet kushtetuese, kur ka trajtuar

vettingun e gjykatësve dhe prokurorëve. Nuk kishte asnjë argument, asnjë arsye që edhe politikanët të trajtohen ndryshe nga gjykatësit, prokurorët apo dhe policët, të cilët i kemi futur në procesin e vettingut. Ju kishit nevojë për kohë për ta sfumuar këtë si çështje. Këtë e tregoi edhe votimi në Këshillin e Legjislacionit, ku pa u mbyllur, pa u zyrtarizuar opinionin e Komisionit të Venecias kur ai ishte vetëm draft, ju e votuat dhe e rrëzuat. Pra qëndrimi i mazhorancës në këtë rast edhe zyrtarisht u bë i qartë sepse politikisht ishte shprehur kohë më parë në të gjitha nivelet duke filluar që nga Kryeministri. Të presësh që të bësh vetting për politikanët me këtë mazhorancë do të thotë që të shohësh ëndrra në diell.

Desha të sjell edhe një herë në vëmendjen Tuaj se çfarë përmban opinionin e Komisionit të Venecias. Opinioni konfirmoi tërësisht qëndrimin e opozitës, të cilën e pranoi nëpërmjet tre pikave, tre gjetjeve apo tre konfirmimeve.

Së pari pranoi që lidhja e politikës me krimin është një shqetësim shumë serioz në Shqipëri. Në paragraf citohet që krimi ka kapur institucionet dhe institucionet i shërbejnë krimit.

Së dyti theksoi që përpjekja e opozitës për të adresuar këtë shqetësim është legjitime.

Së treti, duke folur për thelbin e iniciativës, cënimi apo prekja e imunitetit të të zgjedhurve nuk është cënim i demokracisë, përkundrazi është mbrojtje e demokracisë. Me këto tre pika është ezauruar i tërë qëndrimi i opozitës sepse edhe propozimi ynë këto synonte, të evidentonte se këtu kemi një lidhje të ngushtë të krimit me qeverisjen dhe këtë duhet ta adresojmë në mënyrë ligjore dhe kjo bëhet nëpërmjet cënimit të imunitetit të të zgjedhurve, të cilët mbajnë kontakte me kontingjente kriminale. Për sa i takon shqetësimeve të tjera që ka ngritur Komisioni i Venecias me të drejtë, pasi ne nuk i kemi trajtuar ato në propozimet tona, duke qenë të ndërgjegjshëm se duke pasur vullnet politik këto do të ishin çështje debati ndërmjet palëve. Pra a realizohet vettingu me ligj të veçantë, a realizohet me ligjin e dekriminalizimit si një pjesë më vete e tij, a realizohet me këtë ligj dhe me ndryshimet kushtetuese, se cili është përkufizimi i kontaktit të papërshtatshëm, se kush organizëm do të kryejë vettingun! Në do të jetë organizëm më vete, si në rastin e prokurorëve dhe gjykatësve, do të jetë një organizëm pranë Prokurorisë së Përgjithshme, do të jetë një organizëm pranë SPAK-ut? Këto janë elemente teknike, të cilët mund të zgjidhen vetëm me debatin ndërmjet palëve. Jo më kot Komisioni i Venecias ka bërë thirrje që spektri politik në Shqipëri të debatohet në Kuvend për të adresuar këto çështje, për të gjetur zgjidhje teknike për këto çështje. Pra për sa i përket aspektit politik Komisioni i Venecias e ka pranuar problemin, e ka konsideruar

legjitim që duhet zgjedhur propozimin tonë dhe ka konfirmuar që të qënit i zgjedhur me votë nuk do të thotë që shtete të caktuara, parlamenti i atij vendi të mos ketë të drejtë të prekë mandatin e të zgjedhurit, kur ai ka kontakte të pa përshtatshme me elementë kriminalë.

Çfarë dua të them me këtë!

Edhe një herë dua t'ju bëj thirrje që të ndryshoni pozicionin tuaj, të ndryshoni qëndrim dhe kur të premten e 21 dhjetorit në seancë të diskutojmë se si të realizojmë vettingun e politikanëve dhe jo të vini e ta hidhni poshtë me votë, sikurse vepruat edhe në Këshillin e Legjislacionit në mbledhjen e përbashkët të tij me Komisionin e Ligjeve. Dëshiroj t'ju bëj thirrje edhe asaj pak ndërgjegjeje që mund t'ju ketë mbetur si politikanë të përgjegjshëm, për të parë se në çfarë rruge është futur vendi.

Këtu pas nesh zhvillohet një protestë, në dukje për kërkesa të thjeshta ekonomike, por ajo mbart në vetvete një shqetësim shumë të madh, i cili në një pjesë të caktuar të tij ka rrjedhur po ashtu nga kjo qeverisje dhe nga lidhja e kësaj mazhorance me krimin e organizuar. Në vend që të adresohen problemet e studentëve dhe qytetarëve shqiptarë, synohet që buxheti publik të përdoret në radhë të parë për të kënaqur interesat e oligarkëve dhe kriminelëve, të cilët janë lidhur me fije të dukshme dhe të pa dukshme me këtë qeverisje. Ndaj edhe një herë do t'ju bëja thirrje që, nëse do ta bëni këtë seancë ditën e premte 21 dhjetor përpiquni një herë të vetme të jini seriozë dhe të filloni një dialog të sinqertë, i cili në thelb të ketë miratimin e legjislacionit për vettingun e politikanëve. Pa vetting të politikanëve të jeni të sigurt që nuk ka reforma në këtë vend, nuk ka për të pasur hapje të negociatave për Shqipërinë për anëtarësim në BE dhe shumë objektiva të tjera që ne i kemi si vend, por që prej 5 vitesh nuk po arrijmë t'i realizojmë.

Meqë e kam marrë fjalën edhe një pikë të dytë desha të shtoj. Ditën e enjte diskutohet Dekreti i Presidentit “Për kthimin mbrapsht të buxhetit të shtetit”, ne si opozitë do të dëshironim që dekreti të shqyrtohet me debat në seancën e ditës së enjte datë 20.12.2018. Faleminderit.

Taulant Balla – Zoti Kryetar, kolegë, do të doja t'i uroja opozitës rikthimin në punimet normale të Kuvendit. Ky është një lajm i mirë për funksionimin normal të Kuvendit, qoftë në Konferencë të Kryetarëve, por me çfarë kuptoj edhe në dy seancat e kuvendit. Bie tërësisht dakord me propozimin e zotit Spaho për shqyrtimin në Kuvend të draftit të propozuar “Për ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë” të zhvillohet në datë 21 dhjetor. Kurrësi nuk do t'i shmangesha edhe propozimit tjetër të bërë nga zoti Spaho, përderisa

Rregullorja e kërkon, që dekreti të zhvillohet me debat. Biem dakord për një kohë të caktuar në proporcion mes grupeve parlamentare, siç ka qenë traditë e kahershme e këtij Kuvendi që, kur është bërë fjalë për dekretet të natyrave të ndryshme, për çështje të ndryshme të ketë një kohë, sipas Rregullores, të ndarë mes shumicës dhe pakicës. Dua të shpreh në emër të mazhorancës që ka qenë po praktikë e këtij Kuvendi, të paktën unë dhe zoti Spaho kemi të njëjtën kohë që nga 2005-sa e këtij pa ndërprerje dhe e dimë fare mirë që është praktikë tashmë e konsoliduar e këtij Kuvendi që draftet për ndryshimet kushtetuese i ka konsultuar me Venecian. Edhe në rastet kur nuk i kemi konsultuar kemi pasur eksperiencë kur Komisioni i Venecias është shprehur më pas dhe të dy bashkë e dimë, edhe në rastin e draftit kushtetues për ndryshimet në ligjin e dekriminalizimit, Komisioni i Venecias e ka dhënë mendimin e vet më pas. Ne bashkërisht duhet ta falënderojmë komisionin e Venecias për shpejtësinë që na mundësoi në këtë rast dhe ju lutem që ta lëmë këtë debat për ta zhvilluar në seancën përkatëse të Kuvendit, secila palë me pozicionin e vet, secila palë me leximin e vet, pavarësisht se raporti i komisionit të Venecias është i qartë që në fillim e deri në çdo konkluzion. Nuk kemi përse e diskutojmë në Konferencë Kryetarësh, por kur të shkojmë në seancën e ditës së premte datë 21 dhjetor të zhvillojmë debatin. Për sa i takon çështjes së Dekretit të Presidentit jam plotësisht dakord të kalojë me debat sipas një kohe të caktuar. Besoj se për modalitetet do të biem dakord mes opozitës dhe mazhorancës për kohën e zgjatjes së debatit. Të kemi parasysh që është një seancë e rëndësishme tek e cila do të doja të kujtoja dy elementë të rëndësishëm.

E para, unë besoj se e kemi dakordësinë e opozitës për të përfshirë në këtë seancë edhe ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, meqenëse është dhe seanca e fundit. Puna shumë e mirë e bërë në kohën më të madhe bashkërisht pozitë opozitë, dhe tani këto 3 muaj pa opozitën na ka çuar në një draft të Rregullores së Kuvendit që ka adresuar tërësisht vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por më shumë se kaq edhe eksperiencat e vendeve të tjera, me rregullore, e cila u jep më shumë kohë në dispozicion grupeve parlamentare për të shqyrtuar legjislacionin. Nuk mund të kalojë një ligj direkt në seancë plenare pa u shqyrtuar në grup parlamentar, sikurse lejon edhe një javë në dispozicion të deputetëve për konsultimet me zgjedhësit, por u jep dhe deputetëve mundësinë që në një seancë të posaçme t'i adresojnë problemet që marrin nga zgjedhësit, në seancë plenare ku çdo deputet dhe më pas çdo grup parlamentar ka punën e vet.

Nuk po hyj në prezantim të draftit, por besoj se edhe nga bisedat paraprake biem dakord edhe me opozitën se duhet që Rregulloren e Kuvendit ta azhurnojmë me zhvillimet normale të punës së Kuvendit. Sot në 2018-tën kemi Rregullore Kuvendi, e cila për punën parlamentare

është e njëjta siç mund të ketë pas qenë puna parlamentare me një sistem tërësisht të ndryshëm parlamentar.

E fundit, por më e rëndësishmja nga të gjitha çka u tha më lartë është se, duhet t'ju informoj se deputetët e Partisë Socialiste, anëtarë të Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, kanë depozituar në Kuvend një draft për ndryshime në Kodin Zgjedhor. Është një draft që siç e dini është punuar me asistencën e vyer të ekspertëve, qofshin vendas apo të huaj, me asistencën e dy fondacioneve gjermane Konrad Adenauer dhe Friedrich Ebert me ekspertë vendas të gjithë pranuar ndër më të mirët, siç janë zoti Ilir Rusmali dhe zoti Viktor Gumi. Ky draft tashmë është gati për të hyrë, le të themi në diskutimin normal të Kuvendit. Do të ishte në interes të zgjedhjeve të 30 qershorit, të dekretuara tashmë nga Presidenti i Republikës zoti Ilir Meta, që këto ndryshime në Kodin Zgjedhor, por edhe paketa në tërësi, po të kemi parasysh që paketa implikon edhe ndryshime në ligjin për nëpunësin civil, apo ligje të tjera, të kalojë në seancën plenare të datës 20 apo 21 dhjetor dhe këtë e vendosim së bashku. Në njërën nga këto dy data do ishte mirë të ishte dhe Kodi Zgjedhor, kjo bazuar në kërkesën e deputetëve, bazuar në Rregulloren e Kuvendit. Në cilësinë e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste do bëjmë dhe kërkesën për përfshirje në rend të ditës në një nga këto seanca, për të qenë korrekt edhe me Rregulloren e Kuvendit, por unë besoj që opozita në këtë pikë bie dakord që ne duhet të respektojmë afatin e standardeve më të mira të përcaktuara nga ODHIR, që ndryshimet në Kodin Zgjedhor duhen bërë jo më vonë se 6 muaj nga data e zgjedhjeve. Kjo do të thotë se 30 dhjetori është afati i fundit dhe këto dy seanca që kemi përpara janë shumë të rëndësishme. Mendoj se koha kur partitë politike merrnin përsipër edhe numërimin e votave duhet të marrë një herë e përgjithmonë fund, po të keni parasysh se ky është një rekomandim të paktën në shtatë zgjedhjet e fundit që bëhet nga OSCE – ODHIR në raportet përkatëse, por të paktën tre të fundit nuk i kemi adresuar. Bëhet fjalë për vitet 2013, 2015 dhe 2017. Ka edhe çështje të tjera të cilat nuk është vendi t'i diskutojmë. Shpresoj që edhe për këtë çështje do të kemi dakordësinë e opozitës për të ecur përpara me një Kod Zgjedhor, tërësisht për herë të parë që adreson të gjitha rekomandimet e OSCE – ODHIR dhe tërësisht i bërë me një punë të mirë të ekspertëve, por duke falënderuar në mënyrë të veçantë zotin Oerd Bylykbashi dhe zotin Blendi Çuçi për një punë shumë të mirë që kanë bërë edhe në konsultim me ekspertët vendas dhe të huaj. Faleminderit.

Edmond Spaho – Për sa i takon kthimit në normalitet, nuk është kthim në normalitet. Nuk ka normalitet me Edi Ramën kryeministër, për këtë të jeni të qartë. Jemi kthyer për dy çështje shumë të mëdha.

Së pari, për protestën e studentëve, të cilën e kemi mbështetur dhe do ta mbështesim, por që është e organizuar nga vetë studentët, për të shprehur shqetësimin e tyre për atë që ju kemi paralajmëruar që në 2015-ën, që ligji “Për arsimin e lartë” është një ligj antidemokratik dhe kundër arsimimit të qytetarëve shqiptarë. Është ligj që favorizon universitetet private në kurriz të universiteteve publike dhe rrit koston e arsimimit të studentëve. Dhe ja ku jemi sot, tek ajo që ju paralajmëruam në 2015-ën dhe nuk dëshironit ta dëgjoni.

Të enjten do të jemi në seancën e shqyrtimit të Dekretit të Presidentit për kthimin e buxhetit 2019, pikërisht për të shprehur mbështetjen për kërkesat e studentëve. Për tetë kërkesa të cilat duhet të reflektohen në radhë të parë në buxhetin e vitit 2019.

Së dyti, jemi për vettingun e politikanëve. Kemi deklaruar në shtator se marrëdhënia jonë me Kuvendin e Shqipërisë është marrëdhënie e kushtëzuar. Nëse do të merrni në shqyrtim propozimet tona, paketën tonë për vettingun e politikanëve dhe t’i miratojmë sigurisht do të jemi të hapur edhe për reforma të tjera për t’i shqyrtuar. Ajo që na keni thënë deri tani dhe që po e përsërisni edhe në këtë Konferencë Kryetarësh është që Ju nuk keni vullnet politik për të shqyrtuar propozimin tonë për vettingun e politikanëve. Sikurse e hodhët poshtë në Këshill të Legjislacionit do ta hidhni poshtë edhe në seancë. Nuk ka dy lexime të opinionit të Komisionit të Venecias, ka vetëm një lexim dhe leximi është i qartë në ato tre pika që ju cilësova. Shqipëria ka një problem të rëndë në lidhje me krimin. Përpjekja për ta adresuar atë është legjitime. Mekanizmi për ta adresuar është prekja e imunitetit të gjithë politikanëve, të cilët mbajnë lidhje nga më të ndryshmet, kontakte të papërshtatshme, sikurse është termi juridik në botën e krimit. Prandaj, nëse jeni të sinqertë dhe të vërtetë në ato që thoni, ditën e premte votoni propozimet tona.

Për gjerat e tjera që ngrini për Rregulloren, nuk jemi dakord që të përfshihet në ndonjë nga dy seancat, lëreni për në janar.

Për sa i përket Kodit Zgjedhor do të thosha se sot nuk jemi mbledhur për Kodin Zgjedhor. Nëse doni të diskutojmë për Kodin Zgjedhor, të cilin edhe atë e keni penguar, edhe për Reformën Zgjedhore në tërësi, ku nuk shoh asnjë interes nga mazhoranca, përveç fjalëve për ta përfunduar. Lini një mbledhje tjetër ku të vijnë njerëzit të cilët janë marrë me këtë çështje dhe të mund të paraqesim qëndrimin dhe opinionin e Partisë Demokratike. Faleminderit.

Fatmir Mediu – Faleminderit zoti Kryetar. Për gjykimin tim dy seancat që vijnë janë shumë të rëndësishme, përveç sensibilitetit që kanë qoftë politikisht, qoftë edhe të qytetarëve për sa i përket zhvillimeve në vend. Mendoj që Dekreti i Presidentit për kthimin e buxhetit

padyshim që është një akt politik, por që në vetvete mbart mundësinë e një reflektimi të thellë të të gjitha palëve në Kuvendin e Shqipërisë. Nëse vërtetë duam që t'i japim zgjidhje kërkesave të studentëve, duke lënë mënjanë demagogjinë që jemi dakord për t'i zgjidhur të gjitha, madje ta thellojmë më tej problemin e zgjidhjes së çështjes së arsimit universitar. Mendoj se buxheti është një moment reflektimi i klasës politike shqiptare dhe në mënyrë të veçantë Parlamentit, për të parë se si dhe si mund të përfshihet në buxhetin e shtetit pikërisht zgjidhja e kërkesës së studentëve dhe për të avancuar më pas edhe më tej me çështje që kanë të bëjnë me arsimin universitar dhe sidomos me ligjin që është miratuar në mënyrë të njëanshme. Le ta shikojmë si një oportunitet dhe jo si një kundërshti politike nga ana e Presidentit të Republikës. Një moment i cili mund të na japë mundësinë për t'u thënë atyre djemve dhe vajzave që protestojnë në mënyrë të vazhdueshme për nevojat e tyre dhe padyshim dhe të gjithë shoqërisë shqiptare që ne kemi disponibilitetin për t'i parë seriozisht, duke lënë mënjanë demagogjinë për t'i dhënë zgjidhje atyre kërkesave. Po ashtu edhe çështja që do të shqyrtohet ditën e premte për vettingun në politikë. Nuk duhet ta shohim Komisionin e Venecias si një justifikim për qëndrimet tona politike, por si një marrëdhënie e drejtë për të zgjidhur disa çështje që tashmë janë të dukshme në jetën politike shqiptare. Për sa kohë që ne kemi arritur të gjykojmë me të drejtën apo pa të drejtën tonë pjesën e gjyqtarëve, prokurorëve apo policëve, duhet patjetër që të shohim se kush është raporti i politikës në raport me ato ligje që kemi ndërtuar për pjesën tjetër. Pra le të shikohet si një moment reflektimi rreth kësaj çështjeje.

Çështja që ngriti zoti Balla për sa i përket Reformës Zgjedhore. Unë nuk di në ndonjë vend të botës që të veprohet kështu siç veprohet në Shqipëri! Është përgjegjësia e Kuvendit, do të thosha zoti Kryetar, edhe përgjegjësia Juaj si Kryetar i Kuvendit. Është ngritur një komision për Reformën zgjedhore. Përveç komisionit, që ka përbërje politike të ndryshme, kemi dhe një grup ekspertësh. Këta ekspertë nuk janë mbledhur asnjëherë deri më sot për të dhënë mendimin e tyre për draftin e Reformës Zgjedhore dhe për çudi thuhet se janë përfshirë të gjithë ekspertët edhe ato ndërkombëtarë, në një kohë që ekspertët e përcaktuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë për këtë çështje nuk kanë asnjë dijeni! Po vazhdoj akoma më tej. Ju lavdëroni me të drejtë marrëdhënien dashurore ndërmjet dy bashkëkryetarëve, shumë mirë e bëjnë Ata që rijnë me njëri – tjetrin, por ka një komision legjitim i cili duhet të shqyrtojë një draft të propozuar, siç thoni Ju, para se të jetë në seancë plenare! Nuk ka asnjë diskutim në komision, nuk ka asnjë njohuri për një draft, nuk ka asnjë marrëdhënie me këtë draft nga Komisioni i Reformës Zgjedhore. Të paktën për respekt të kolegëve Tuaj të mazhorancës, duhet që formalisht, pra deputetët e Partisë Socialiste formalisht të diskutojnë mbi këtë draft. Nuk është

e drejtë ekskluzive as Blendi Çuçit, as e Oerd Bylykbashit, as e Fatmir Mediut dhe askujt tjetër që të thotë se po e sjell këtë draft jashtë vendimit që është marrë për Komisionin e Reformës Zgjedhore. Kjo ndodh për herë të parë dhe nuk ka asnjë gjë thelbësore që përmirëson dhe garanton zgjedhje të lira dhe të ndershme. Janë krejt anësore dhe të pa vlefshme edhe ato propozime që përmendët Ju për sa i përket komisionerëve. Nuk është problemi aty. Nuk janë shqyrtuar në themel dhe në thelb çështjet e blerjes së votës, manipulimit të zgjedhjeve, legjitimitetit kushtetues të Kuvendit të Shqipërisë. Si do të zgjidhet? Kjo është bërë në një datë që diskutohet qoftë me OSCE-në, qoftë me Këshillin e Europës, qoftë edhe me institucione të tjera pa përfshirjen dhe pa mendim të vetë përfaqësuesve politikë që e njohin këtë proces për më shumë se 27 vjet, apo ekspertët që janë marrë me këtë çështje. Të mos bëjmë gjëra të cilat janë krejtësisht të papranueshme dhe të pavlefshme për sa i përket punës së Kuvendit, apo obligimin kushtetues dhe ligjor që ka, dhe për më tepër më pas për mundësinë për të bërë zgjedhje të lira dhe të ndershme në Shqipëri! Pra jam tërësisht kundër që të vijë një draft, të na përcillet sikur po e lëmë edhe këtë sot se nuk ka asgjë që duhet të diskutonim. Ashtu siç bëmë edhe me një pjesë të Reformës në Drejtësi dhe sot jemi një vit pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë sepse kështu e thamë, na e kanë sjellë mos e lexoni nuk ka nevojë por miratojeni!

Gramoz Ruçi – Ka diskutime të tjera? Nuk ka. Atëherë biem dakord për datën 21 dhjetor ora 10.00 ku do të diskutohet nisma e opozitës “Për ndryshimet kushtetuese”. Do të lini diskutim të lirë apo do të vendosni kohë debati? Si e mendoni?

Taulant Balla – Seanca siç e dini ka edhe ligje të tjera në rend të ditës, prandaj unë do të propozoja që të kishte 6 orë debat për këtë çështje të ndarë proporcionalisht mes palëve edhe debati ka kuptim.

Gramoz Ruçi – Po flas për nismën e opozitë një herë, më pas do kalojmë tek Dekreti i Presidentit.

Edmond Spaho – Për të dy pikat unë do të konsultohem me grupin për të dy seancat në ditët e enjte dhe të premte.

Taulant Balla – Seanca e të premtes është e thjeshtë pasi ka vetëm një çështje në rend të ditës. Ju keni kërkuar debat me kohë tek Dekreti i Presidentit për kthimin e buxhetit 2019-të.

Edmond Spaho – Jo vetëm për dekretin, por sikurse kërkojmë që asnjë çështje tjetër të mos përfshihet në rendin e ditës.

Taulant Balla – Si asnjë çështje tjetër, se nuk e kuptoj!!!!

Edmond Soaho – Për Rregulloren Ju thashë. Për këtë e kam fjalën. Të miratohet në janar.

Taulant Balla – Ju e dini që Rregullorja është miratuar gjithmonë me konsensus. Fakti që Ju nuk jeni dakord të miratohet tani, pavarësisht se..... Të jemi të sinqertë me njëri-tjetrin dhe të mos më thoni më, jashtë kësaj godine, që jemi dakord por miratojeni vetë. Kaq, kurse për pjesën tjetër

Edmond Spaho – Zoti Balla për Rregulloren kemi qenë të qartë dhe arritëm një konsensus në shkurt, i cili nuk na prodhoi rezultat në seancë. Sot pas 10 muajsh ne nuk jemi dakord që të shqyrtohet në këto dy seanca, por të shtyhet për në janar. Ndaj jam shumë i qartë në ato çka të kam thënë më përpara. Mos bëj diversione që nuk janë të ndershme.

Taulant Balla – Të lutem zoti Spaho. Ajo që po them unë është komplet gjë tjetër.

E para, është planifikuar për në seancë dhe sigurisht që do të shtyhet me konsensus të të dy palëve. Këtë po them unë, pavarësisht se të gjithë biem dakord se ato ndryshime në Rregullore janë të gjithë pranuar edhe nga Ju edhe nga Ne.

E dyta, për sa i përket çështjes së Kodit Zgjedhor, Ju e dini fare mirë që edhe në mungesën Tuaj në Parlament ne kemi shtyrë afatin e Komisionit të Reformës Zgjedhore, por këtij komisioni i mbaron mandati përpara se të fillojë sesioni i ardhshëm. Dhe si i tillë Kuvendi i Shqipërisë duhet të shprehet po me vendim më datë 20 ose 21 dhjetor për këtë çështje. Është Kuvendi që vendos nga Konferenca e Kryetarëve.

Edmond Spaho – Zoti Balla Ju thashë se unë këtu nuk jam autorizuar që të vij dhe të flas për çështjen e Reformës Zgjedhore. Unë kam ardhur për Dekretin e Presidentit dhe për vettingun e politikanëve. Të shpreha edhe rrugën për të adresuar shqetësimin tënd.

Taulant Balla – Atëherë, atyre që duhet t'i kërkonin edhe për çështjen se për sa kohë do të jetë debati, ju lutem transmetojeni edhe këtë çështjen e domosdoshmërisë për të respektuar standardin e ODHIR-it që ka të bëjë me miratimin e legjislacionit zgjedhor 6 muaj përpara zgjedhjeve. Më pas modalitetet i diskutojmë përsëri.

Edmond Spaho – Më duket se edhe këtë po e hidhni si një shashkë, pasi nëse do të ishte me të vërtetë shqetësim do ta kishit diskutuar atje në Komision të Reformës Zgjedhore, i cili po na funksionuaka kaq mirë dhe i paska mbaruar të gjitha punët dhe i paska mbetur vetëm afati tani! Ndaj ti lëmë këto.

Gramoz Ruçi – Ju lutem ka mundësi ta sqaroj unë. Atëherë biem dakord që seanca të jetë më datë 21 dhjetor. Për kohën e debatit vendoseni Ju kryetarët e grupeve. Të bini dakord për një orar të caktuar, po kështu edhe për Dekretin e Presidentit të Republikës, Na thoni që ta parashikojmë për në seancë.

Lidhur me Rregulloren, është në axhendën e Kuvendit, ka kohë që është! Tradita e mirë që ka qenë në këtë Parlament, është se këto 28 vite që ka ndryshuar Rregullorja, gjithmonë është bërë me konsensus. Ndërsa ka një kërkesë për t'u shtyrë për sesionin tjetër parlamentar, në janar. Do të shtrohet edhe në seancë dhe nuk ka ndonjë arsye të qenësishme për të pritur edhe një muaj.

Lidhur me ndryshimet e kohës, do të isha shumë i lumtur nëse do të ishte një produkt i komisionit Ad-hoc. Nuk është produkt me gjithë negociatat që ka pasur edhe me ndërmjetësimin e partnerëve ndërkombëtarë që merren me këtë çështje. Unë jam para faktit të kryer ku nisma është depozituar me tetë firma, anëtarë të komisionit të mazhorancës. Në komisionet e tjera kjo nisëm nuk kalon, pasi është nisëm deputetësh anëtarë të komisionit, pavarësisht se është e një anshme.

Së dyti, jam para faktit të kryer që ne e kemi shtyrë disa herë mandatin e këtij komisioni Ad-hoc. Mandati i tij quhet i përfunduar tashmë pasi edhe koha e përfundimit i takon në ditët e pushimeve, në mos gaboje në 15 janar i mbaron mandati. Kërkesa është që të realizohet gjashtë muaj përpara, se çfarë vendos seanca, sigurisht kurdo që ta shqyrtojë, qoftë në 20 apo 21. Nëse nuk janë numrat përkatës ky është Kod dhe nuk diskutohet, prandaj nuk kemi përse të bëjmë debat, por procedurialisht jemi këtu.

Në përfundim do të doja të thosha vetëm një gjë zoti Spaho! Ju bëtë një kritikë, meqë e drejtoj unë Këshillin e Legjislacionit dhe Komisionin e Ligjeve në rastin e nismave kushtetuese. Duhet të dini një gjë për faktin që e votuam dhe e rrëzuam pa pritur mendimin e Komisionit të Venecias. Pavarësisht se nuk ishte mbledhja e Këshillit të Legjislacionit kishte raportin paraprak të cilin unë e parashitova në mbledhje të Këshillit të Legjislacionit dhe të Komisionit të Ligjeve, megjithatë edhe në funksion të këtij shqetësimi që trajtuat Juve, unë e

kisha atë shqetësim dhe i kërkova përfaqësuesve tuaj që kishim në Këshillin e Legjislacionit mendimin e tyre. Nëse ata do të binin dakord që ne të shqyrtonim në datë 7 dhjetor unë do të njoftoja mbledhjen e Këshillit të Legjislacionit dhe për Komisionin e Ligjeve. Nëse ata nuk do të ishin dakord, sigurisht që unë nuk do ta zhvilloja dhe e lamë në mbledhje pa datë. Pastaj më kthyen përgjigje dhe më thanë se, do ta diskutonin ditën e premte më datë 7 dhjetor. Ndaj ishte ky vullnet që e bëri realitet gjithmonë me predispozicionin për të mos e shtyrë, pasi më pas kishte dy variante që ta mbyllja Këshillin javën që vjen, që do të thotë se do të thërrisja Parlamentin në seancë të jashtëzakonshme, pasi është 2 deri në 3 javë përpara datës 21 dhjetor. Ose të shtyja Këshillin e Legjislacionit në fund të muajit janar dhe më pas të zbatoja Kushtetutën.

Edmond Spaho – Zoti Kryetar, e pranoj shpjegimin Tuaj, por nuk është ky thelbi.

Gramoz Ruçi – Rakordohuni pozitivë opozitë për kohën në të dy debatet, faleminderit.

MBLEDHJA MBYLLET